



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr.91, Datë 02.06.2020

“MBI

PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE TË NISUR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 87, DATË 19.05.2020, “PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS NR. 402, SERIA P18, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 83, DATË 06.04.2018, “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “FAVINA 1” SHPKNË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “VOSKOPOJË” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1970 KW”.

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar nenit 64 90 pika 3, 94 pika 1 dhe 113 të ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i procedurës administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenit 15 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 109, datë 29.06.2016 si dhe nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi shfuqizimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 87, datë 19.05.2020,

Konstatohet se:

- Shoqëria “FAVINA 1” Shpk, me shkresën nr. 17 prot, datë 16.04.2020, protokolluar në ERE me nr. 650, datë 22.04.2020, ka përcjellë kërkesën për modifikimin e licencës nr. 402, Seria P18, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 83, datë 06.04.2018, “Për licencimin e shoqërisë “FAVINA 1” Shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Voskopojë” me kapacitet të instaluar 1970 kW”.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 87, datë 19.05.2020, vendosi për fillimin e procedurës për modifikimin e licencës nr. 402, Seria P18, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 83, datë 06.04.2018, “Për licencimin e shoqërisë “FAVINA 1” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Voskopojë” me kapacitet të instaluar 1970 kW”.
- Në datë 19.05.2020, në ERE është depozituar shkresa e shoqërisë “FAVINA 1” Shpk “Njoftim për anulimin e kërkesës për modifikimin e licencës nr. 402, Seria P18, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 83, datë 06.04.2018, “Për licencimin e Shoqërisë “FAVINA 1” Shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Voskopojë” me kapacitet të instaluar 1970 kW”, nëpërmjet së cilës kërkon që ERE të mos marrë në konsideratë kërkesën për modifikimin e licencës

së sipërcituar, pasi për shkak të kushteve të vështira të krijuara nga Pandemia COVID-19, ndodhet në pamundësi financiare për të investuar shtesën e kapacitetit të instaluar të HEC “Voskopojë” nga 1970 kW në 2400 kW.

- Neni 64 i Kodit të Procedurave Administrative, në pikën 2 parashikon se:
 - *Një palë, me anë të një kërkesë me shkrim, mund të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga procedura administrative dhe të heqë dore nga të drejtat dhe interesat e saj ligjore, përveç rasteve kur kjo ndalohet me ligj.*
 - *Pas tërheqjes së një pale, organi publik vendos përfundimin e procedurës administrative.*
- Në pikën 1 të nenit 94 të Kodit të Procedurave Administrative, parashikohet se: *Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë.*

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi :

1. Përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e bordit të ERE-s nr. 87, datë 19.05.2020, “Për fillimin e procedurës për modifikimin e licencës nr. 402, seria p18, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 83, datë 06.04.2018, “për licencimin e shoqërisë “favina 1” Shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Voskopojë” me kapacitet të instaluar 1970 kw
2. Vendimi i bordit të ERE nr. 87, datë 19.05.2020, “Për fillimin e procedurës për modifikimin e licencës nr. 402, seria p18, të miratuar me vendimin e bordit të ere-s nr. 83, datë 06.04.2018, “për licencimin e Shoqërisë “Favina 1” Shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “voskopojë” me kapacitet të instaluar 1970 kw, shfuqizohet.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brënda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI